



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2021:262127

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05518989

E.nr.447/10

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri dhe bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K... SH.A., me seli në Prishtinë, ..., kundër debitorit N.Sh nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, lidhur me pagesën e borxhit, jashtë seance me datë 28.03.2024, mori këtë:

**K O N K L U Z I O N**

I. PEZULLOHET procedura përmbartimore në çështjen E.nr.447/10 për shkak të vdekjes së debitorit.

II. Procedura e pezulluar sipas pikës I të këtij konkluzioni mund të vazhdojë nëse kreditori në afat prej 6 muajsh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, gjykatës i propozon caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për debitorin N.Sh, në të kundërtën procedura e pezulluar konsiderohet e përfunduar.

**A r s y e t i m**

Kreditori K... SH.A, me datë 27.08.2010, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit N.Sh nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, në bazë të dokumentit të besueshëm, dhe atë faturës me numër 7/2010/R – 2392888, të datës 31.07.2010, me të cilën është obliguar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 2,221.39 Euro në emër të borxhit si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata me aktvendimin E.nr.447/10 të datës 22.09.2010, e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit. Nga certifikata e vdekjes e datës 20.02.2023, me numër të referencës ..., gjykata ka konstatuar se debitori ka vdekur me datë *data e vdekjes*.

Meqenëse nga dita e vdekjes e deri më sot nuk është propozuar përfaqësuesi i përkohshëm për debitorin N.Sh, dhe as nuk ka marrës përsipër të procedurës në këtë çështje, gjykata konform nenit 35 par. 4 lidhur me nenin 65 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

E.nr.447/10, me datë 28.03.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij konkluzioni, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.